



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

KOMUNA KLINE

Zyra e prokurimit

01 Nr. 104-36707/21

Date 19.10.2021

KONTRATË PUBLIKE KORNIZË NR 94-2021 634-21-5605-1-2-1/C398

KUVENDI KOMUNAL I KLINËS (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;

dhe

MEDIATECH & PRINT SH.P.K., TREGU ME SHUMICË TE AMORTIZATORËT, PRISHTINË, me numer te Bisnesit 810839425 me pronar z. Hajriz Zabeli (në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizim me:

FURNIZIM ME BANKA DHE KARRIKA PER NXENES numër identifikues: **634-21-5605-1-2-1**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratë publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit për dorëzimin e mallrave në vijim:

FURNIZIME SIPAS PERSHKRIMIT NCMIMORE

Nr.	Grupi
1	FURNIZIM ME BANKA DHE KARRIKA PER NXENES

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontratë publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë mallëratë përmendura në 1.1. .

1.4 Kontrata hyjnë në fuqi me 30.09.2021 dhe përfundon në datën 20.12.2021

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë **brenda 30** ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë SHKOLLA SIPAS FLETEURDHERESES SE DKA KOMUNA KLINE

2.3 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP^I (Dërgesat e Detyrës të Paguara). KLINE

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

Nr.	Titulli	Çmimi për njësi (me TVSh)	Sasia	Njësia matëse	Totali (me TVSh)
1	Banka për nxënës Specifikacioni- Skeleti i bankës duhet të jetë nga metali i zinguar me profil 2mm me dimensione 20mm x 20mm.; Sipërfaqja e bankes 60cm x 120cm, lartësia 74cm nga materiali mediapan me trashësi 1.8mm, ngjyrë druri; Banka duhet të ketë anesoren dim.20cm x 120cm, thellësia 40 cm, mbajtëset e qantave 2 copë në një bankë.	34.810	200.00	COPE	6,962.00

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Nderkombëtare e Tregtisë

2	Karrika për nxënës - Specifikacioni - Skeleti i karrikës duhet të jetë nga metali i zinguar me profil 2mm me dimensione 20mm x 20mm ; Pjesa ulëse dhe mbështetëse të jetë nga materiali druri i presuar i standardit evropian. Këmbët e karrikës të jenë përforcuara me profile metali të njëjta sikur skeleti (në tri anët). Lartësia dhe gjerësia e karrikës të jetë e modelit standard për nxënës për kl. 1-9.	18.054	400.00	COPE	7,221.60
---	---	--------	--------	------	----------

4.1 Çmimet njësi të furnizimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Furnizuesi. Vlera totale indikative e kontratës është **14 183,60** Euro. Derivimi i lejuar nga vlera totale indikative është [shëno përqindjen].

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetnja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës publike kornizë.

4.3

[Çmimet per njësi janë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë kornizë

4.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;
- (g) *SIPAS SPECIFIKACIONIT DHE MOSTRAVE TE PREZENTUARA NE OFERT.*

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të